

## **Projekt me FSVC**

Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC) është një organizatë jofitimprurëse që mbështet zhvillimin ekonomik duke forcuar sektorët financiarë në vende të ndryshme, të cilët janë jetike për të nxitur krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike dhe një cilësi më të mirë jetese.

FSVC ofron asistencë teknike praktike për partnerët lokalë nëpërmjet ekspertëve të sektorit financiar që punojnë në mënyrë vullnetare.

Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF) që prej vitit 2020 ka qënë një nga institucionet përfituese që ka është mbështetur nga FSVC nëpërmjet:

- Organizimit të aktiviteteve trajnuese për AIF dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse përkatëse të përfshira në vlerësimin kombëtar të rrezikut të rreziqeve të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (PP/FT), duke u përqëndruar tek institucionet financiare;
- Harmonizimit të kuadrit mbikëqyrës të AIF me atë të Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për rreziqet e PP/FT, duke u përqëndruar veçanërisht në forcimin mbikëqyrjes së bazuar në rreziqet PP/TF;
- Organizimi i mbikëqyrjes së përbashkët mes AIF dhe autoriteteve mbikëqyrëse;
- Përgatitja e instrumenteve të mbikëqyrjes në vënd dhe në distancë të subjekteve të ligjit nga AIF
- Hartimit të udhëzuesit për vlerësimin e rrezikut PP/FT nga subjektet e ligjit të bazuar në të dhënat e rrezikut të klientit, produkteve, shërbimeve dhe shtrirjes gjeografike;
- Organizimit të aktiviteteve të trajnimit për institucionet financiare, noterët, avokatët, kontabilistët etj;
- Organizimit të aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve të sektorit të OJF në Shqipëri, në funksion të përputhshmërisë me standardet PP/FT dhe mbrojtjes nga rreziqet me të cilat veprimtaria e tyre bamirëse mund të përballlet brënda dhe jashtë vëndit;
- Përmirësimi i kapaciteteve të faqes zyrtare të AIF për komunikimin me publikun dhe subjektet e ligjit;

## **Projekti EU4FOCAL**

Projekti “Për luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri përmes hetimeve penale dhe financiare (EU4FOCAL)” synon të përmirësojë luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut të drogës në vend nëpërmjet metodave proaktive të hetimit dhe inteligjencës. Projekti ka filluar në 1 Mars 2021 dhe do të zgjasë deri në 01 Maj 2024.

Për të arritur këtë objektiv, projekti ka angazhuar specialistë spanjollë nga Prokuroria e Përgjithshme e Shtetit dhe Ministria e Brendshme, konkretisht, nëpërmjet Policisë Kombëtare. Projekti i bashkëpunimit me financim të Bashkimit Evropian, udhëhiqet nga Spanja dhe mbështetete nga autoritetet Italiane dhe Holandeze.

## **Projekti i BE dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perendimor dhe Turqinë Faza III**

Objektivi i përgjithshëm i këtij aktiviteti është të kontribuojë në rritjen e përputhshmërisë së përfituesve të instrumentit të para-aderimit (IPA II) me standardet evropiane dhe kuadrin ligjor të BE-së në fushat e sundimit të ligjit, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias duke mbështetur proceset e reformave përkatëse. Këshilli i Evropës në sajë të aktivitetit dhe përvojës së tij ofron një sistem shumë të ndërlidhur ndërmjet vendosjes së standardeve, monitorimit dhe asistencës teknike në këto fusha kyçe. Agjencia e Inteligjences Financiare eështee njee nga institucionet përfituese tee keetij projekti i cili do tee ofrojee mbeeshtetje nee përputhshmërinë e legjislacionit nee fusheen e parandalimit tee pastrimit tee parave dhe financimit tee terrorizmit me standardet ndeerkombeetare, kuadrin ligjor të BE, forcimin e kapaciteteve njerezore nee fusheen e analizees see informacionit dhe hetimeve financiare, mbikeeqyrjees see subjekteve tee ligjit mbi bazeen e rrezikut PP/FT dhe vlereesimin kombeetar tee rrezikut PPP/FT.

Ky projekt ka filluar në vitin 2016 dhe aktualisht po realizohet faza e tretë e tij, e cila ka filluar në muajin Janar 2023 dhe do të zgjasë deri në vitin 2026. Kjo fazë vijon të konsolidojë rezultatet e arritura në fazat e mëparshme.